Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 85/17
Datë/Datum. 07.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP).**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.85/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me kompjuter"**, me nr. prokurimi: **214-17-04-136.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "ARITECH" sh.p.k, - Livaxhe.**		
Datë	**07.04.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me kompjuter"**, me nr. prokurimi: **214-17-04-136,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP),** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **"Aritech"sh.p.k**, me seli në – Livaxhe, me nr.prot.**85/17**, i datës **24.03.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		29.03.2017		30.03.2017		07.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 24.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 85/17 e parashtruar nga operatori ekonomik "Aritech"sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me kompjuter", me nr. prokurimi: 214-17-04-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP).
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: NPN "Proing & PMN & ingeneering Group"- Prishtinë.

Neni 7 i LPP-së, (Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi).

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne i kemi deshmuar me argumente te qarta AK-se qe produktet e ofertuara nga OE i cili eshte shpallur per dhenie te kontrates eshte ne shkelje te kushteve te kerkuara.

Kerkesat e AK-se rreth shtepizes paraqesin standarte te dyfishta, perderisa njeri nga operatoret lejohet te ofroje MINI TOWER, ndërsa OE Aritech shpk, I referohet qe nuk i ka permbush kerkesat ne dosje te tenderit.

Per produktin me nr.rendor 2. Kompjuter Personal ,kemi dhene sqarime per Autoritetin tuaj qe operatori ekonomik qe eshte shpalle per dhenie te kontrates ka ofruar MINI TOWER jo MIDI Tower,ne specifikacion eshte shume e qarte qe ka nderhyrje sepse nuk ka njekohesisht shtepize te tille MINI TOWER. edhe MIDI TOWER.

Ne cdo kerkim qe kemi bere ne WEB-faqe rreth specifikave te modelit te ofertuar theksohet qarte:

CHASIS

Form Factor - MiniTower Manufacturer form Factor - Mini tower (eshte ndryshuar ne specifika te bera vet nga operatori ekonomik)

Prandaj ne theksojme qe ketu ka falsifikim te specifikave!

Shih specifikat e linqeve ne vijim:

https://www.cnet.com/products/dell-vostro-3900-core-is-4460-3-2-ghz-4-gb-500-gb-usenglish-qwerty/SpecS/

http://www.dell.com/in/business/p/vostro-3900-mini-tower/pd

https://cdn.cnetcontent.com/01/34/0134fc45-3ec6-4cec-8e4f-0elb7cb08970.pdf

Ne lidhje me Laptopin ne iu kemi argumentuar qe laptop te tille te rinj te ofruar nuk ka tash e disa vite, ka por vetem te perdorur dhe qartesisht jashte garancionit nga prodhuesi (produkte qe jane END of LIFE!!!).

Eshte detyre e AK-se te kontrollon rreth informacionit te ofruar nga ne.

Ne prape me dt. 17.03. iu kemi derguar informacione dhe argumente shtese per t'ju ndihmuar ne lidhje me faktin qe tek oferta nga OE i shpallur fitues behet fjale per produkte qe nuk shiten/prodhohen me (dmth nuk plotesojne kerkesat e AK-se), referojuni ketij "printScreen" nga faqja zyrtare e DELL. (Gjeni bashkangjitur)

E para behet fjala qartesisht per MiniTower (qe ka qene baze per eliminimin tone), e dyta ky produkt ka kohe qe nuk shitet dhe produktet si ky nuk gezojne as suportin e prodhuesit as garancionin dhe as pjese reserve!

Nga AK-ja nuk kemi marr asnje pergjigje rreth informacioneve dhe argumenteve me lart.

5/4

Me aq sa eshte deshmuar me larte, AK ka pasur deshmi te mjaftueshme qe te rikthej vendimin per anulim dhe te kthej lenden ne Rivleresim.

LUSIMI ORGANIN TUAJ OE KETE LENDE TA KTHEJ NE RIVLERËSIM.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së: 14.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....kuotim i çmimit
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Furnizim
Afati i fundit për pranim të tenderëve..... .....24.02.2017
Data e hapjes së ofertave:.....24.02.2017. ora 14:30h
Njoftimi për dhënien e kontratës.....07.03.2017
Kriter për dhënien e kontratës.....Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vëretje
1	ARITECH	PRISHTINË	-	5,359.00€	JO
2	ILIR KOSOVA	PRISHTINË	-	6,777.00€	JO
3	COMTRADE	PRISHTINË	-	5,793.00€	JO
4	OHLINE	PRISHTINË	-	5,655.89€	JO
5	IT. MARKET SHPK	PRISHTINË	-	8,898.00€	JO
6	MEDIATECH	PRISHTINË	-	5,701.21€	JO
7	NTP INTRADE	PRISHTINË	-	4,950.00€	JO
8	INFO COM	PRISHTINË	-	5,553.00€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit, ka marrë pjesë tetë (8) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 , Neni 65 ;

2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendi të Operatorit Ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit ;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson Kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit, duhet të dorëzohet në (Origjinal).

2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e hapjes së këtij aktiviteti,) (duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës (Origjinal).

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit. Ofertuesi jo rezident, sipas LPPS-së 04/L-042, është i detyruar të paraqesë certifikatën e regjistrimit të njësisë së përhershme.

2. Regjistrimi i numrit fiskal

3. Regjistrimi i TVSH-së

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit (e kompletuar) – (Kopje)

2. Certifikata e numrit fiskal – (Kopje)

3. Certifikatës se TVSH-es. – (Kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
N/A

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional

- Referenca të kryerjes së furnizimeve të njëjta si në titull të këtij Njoftimi, gjatë tre viteve të fundit 2014,2015,2016 (së paku një referencë)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Referenca të kryerjes së furnizimeve të njëjta si në titull të këtij Njoftimi, gjatë tre viteve të fundit 2014,2015,2016 (së paku një referencë) (kopje).

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Mentor MAXHUNI: Kryesues,
Beqir BEQIRI: Anëtar,
Ardita MIKULLOVCI; Anëtar,

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit ekzaminimit, vlerësimit të ofertave ka konstatuar se OE-të të përgjegjshëm sipas kërkesave të AK-së, janë:

1. OE ONLINE NTP,
2. IT MARKET sh.p.k,
3. INFOCOM,
4. ILIR KOSOVA,

Andaj, komisioni vlerësues me vendim unanim REKOMANDON që OE INFOCOM, me çmim me të ulet të shpërblehet me kontratë, pasi që i përmbush të gjitha kërkesat e AK-së.

Komisioni vlerësues përfundoj vlerësimin e ofertave me datë 02.03.2017.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur koutim çmimit/ furnizim, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës të datës 07.03.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues ARITECH sh.p.k, ka parashtruar kërkes për ri-shqyrtim të vendimin fillimisht në Autoritet kontraktues, pastaj duke parashtruar ankes edhe në OSHP, me datë 24.03.2017, me pretendimet ankimore se nuk janë respektuar neni:

Neni 7 i LPP-së, (Barazia në trajtim jo/diskriminimi),

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes,

konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor nr.1,
Eksperti shqyrtues, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket produktin nr.1 Llaptop Core I5, dhe produktit nr.2 Kompjuter personal (shtëpiza), se i njëjti OE i rekomanduar për kontrat NUK ka ofruar sipas specifikimit të kërkuar në FDT, dhe kërkesës të dosjes pika 7, garancion për produktin.
Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor sa i përket garancionit në lidhje me produktin nr.1 Llaptop Core I5, OE i rekomanduar për kontrat në harmoni me kërkesën e FDT-së pika 7, ka ofruar garancion 1 vjeqar me shkrim i volusor dhe nënshkruar nga ana e OE të rekomanduar për kontrat. Njëherit OE i rekomanduar për kontrat ka ofruar garancion konform kërkesës së FDT-së.

Pretendimi ankimor nr.2,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifimit teknik për produktin nr. 2, kompjuter personal (shtëpizë), në kërkesën e dosjes tek specifikimit teknik është kërkuar që form factor të jetë MIDI TOËER ose TOËER, ndërsa OE i rekomanduar për kontrat në ofertën e tij ka ofruar duke përshkruar specifikimin MIDI TOËER që është në harmoni me specifikimin teknik, ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se i njëjti OE fitues nuk mundet të furnizoj këtë produkt sipas përshkrimit teknik, Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues është i obliguar që gjatë implementimit të kontrates të ketë parasysh specifikimin teknik gjatë pranimit të këtyre produkteve, dhe kjo është një faze tjeter e cila ka të bëjë me implementimin e kontratës.

Pretendimi ankimor nr.7,
Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me nenin 7 të LPP-së, për faktin se kriteret e dosjes NUK kanë qenë diskriminuese, duke u bazuar në atë se asnjë nga OE pjesëmarrës NUK kanë parashtruar ankes në lidhje me kriteret e dosjes, poashtu gjatë vlerësimti të ofertave AK-ja ka bërë trajtimin të barabart të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit në harmoni me nenin 7 të LPP-së.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të REFUZOJ si të PABAZUAR ankesën e OE ankues, për këtë aktivitet të prokurimit: "Furnizim me kompjuter", me nr. prokurimi: 214-17-04-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), njëherit të aprovohet vendimi i Autoritetit kontraktues Njoftimit për dhënien e kontratës i dt.07.03.2017 si i bazuar.